
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

Data: 21.08.2025

PROCESVERBAL- TIPI I KONTRATËS - MALLRA

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

Objekti i procedurës: Blerje automjete për Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarimit dhe Qendrën e Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes, ndarë në 2 (dy) lote:

Loti 1: Blerje automjete për Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarimit.

Loti 2: Blerje automjet për Qendrën e Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP): 34100000-8 Automjete

VLERA E FONDIT LIMIT: 7,373,829 (shtatë milion e treqind e shtatëdhjetë e tre mijë e tetëqind e njëzet e nëntë) **lekë pa TVSH.**

Loti 1: Blerje automjete për Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarimit me fond limit: **4,082,329** (katër milion e tetëdhjetë e dy mijë e treqind e njëzet e nëntë) **lekë pa TVSH.**

Loti 2: Blerje automjet për Qendrën e Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes me fond limit: **3,291,500** (tre milion e dyqind e nëntëdhjetë një mijë e pesëqind) **lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Loti 1: Blerje automjete për Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarimit.

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera,

Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimi/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 26 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të lotit**. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “*Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata*”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c ku përcaktohet se: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...”. Në nenin 55 pika 4 të VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar është përcaktuar se: “Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”.

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit të këtij loti është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur të thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi referuar dispozitave ligjore si më sipërcituar.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 20 % e vlerës së fondit limit të lotit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 55, pika 4(b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55 pika 4 gërma (b) e VKM nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke qënë se vlera e fondit limit është nën kufirin e ulët monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2. Autorizim nga prodhuesi ose nga distributor i autorizuar nga prodhuesi për llojin e mjetit të ofruar. Në rastin e distributorit të autorizuar të paraqitet edhe dokumenti që vërteton se distributori është i autorizuar nga firma prodhuese. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: tel, *fax*, *email*, *website*, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri AK gjykon se autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm i cili garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të mallit objekt prokurimi. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallit që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë që ka servis të specializuar dhe garanton kryerjen e shërbimeve për riparimin e mjetit objekt i prokurimit, gjatë periudhës së garancisë, në servisin e tij / një servisi të marrë me qera, apo përmes një servisi me të cilin mund të ketë të lidhur një kontratë bashkëpunimi të vlefshme përgjatë kohës së realizimit të kontratës, dhe të specifikojë adresën e servisit.

Argumentimi: Bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se disponojnë mjediset e përshtatshme të autorizuara për kryerjen e shërbimeve të riparimit brenda periudhës së garancisë.

4. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatë të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- ISO 9001:2015 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” (e vlefshme) ose ekuivalent;

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 77 dhe 79 të LPP, të pikës 1, nenit 44, të VKM-së nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Ky kriter është kërkuar me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë sipas objektit të kësaj kontrate. Ky standard përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. Kjo certifikatë lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës me cilësi dhe në kohë.

5. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë katalog ose skedë teknike nga prodhuesi /ose distributori i autorizuar ku të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat teknike të mjetit të ofruar, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat standarte të tenderit, të përcaktuara në Shtojcën 6 të DST-së.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të krahasuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike dhe standartet e kërkuara nga AK me specifikimet teknike për mjetet e ofruara nga operatori ekonomik.

6. Operatori ekonomik duhet të deklarojë që mjetet janë prodhuar në vendet e Bashkimit Europian ose të jenë të prodhuara për përdorim në vendet e BE. Për të vërtetuar këtë duhet të paraqesë deklaratën e cila të jetë e shoqëruar me certifikatën e konformitetit (CoC)/ekuivalent.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të

verifikuar plotësimin e specifikimeve teknike të mallit, objekt prokurimi. Duke qenë se mjeti është kërkuar të jenë prodhuar në vendet e Bashkimit Europian ose të jenë të prodhuara për përdorim në vendet e BE, detyruesisht është kërkuar paraqitja e certifikatës së konformitetit si dokumenti zyrtar i cili vërteton se një produkt plotëson standartet europiane të sigurisë, cilësisë, performancës, emetimit të gazrave dhe mbrojtjes mjedisore. Gjithashtu certifikata është një nga dokumentet e detyrueshëm që shoqëron automjetin për të vijuar me regjistrimin e tij në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor

7. Deklaratë garancie për mjetin e ofruar, ku të jetë përcaktuar periudha e garancisë jo më pak se 3 vjet ose 100,000 km.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër periudhën e garancisë për mallin e prokuruar. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që malli objekt prokurimi është në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të gjitha riparimet dhe shërbimet e përcaktuara në deklaratë do të kryhen te operatori ekonomik kontraktues.

8. Deklaratë ku merr përsipër dorëzimin e mjeteve të targuara dhe regjistruara në pronësi të autoritetit kontraktoror përfitues, ku të ketë të përfshira në çmim të gjithë dokumentacionin përkatës për qarkullim në përputhje me legjislacionin përkatës të Republikës së Shqipërisë.

Argumentim: Në bazë të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e kriterit, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për t’u garantuar se mjeti do të dorezohet pranë AK i pajisur me të gjithë dokumentacionin e rregullt tekniko-ligjor, i gatshëm për qarkullim rrugor në emër të AK-së

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Loti 2: Blerje automjet për Qendrën e Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes.

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënua për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënua ose nuk ka qenë i dënua nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera,

Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas **Shtojcës 9**;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas **Shtojcës 4**;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 26 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të lotit**. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “*Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata*”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c ku përcaktohet se: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...”. Në nenin 55 pika 4 të VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar është përcaktuar se: “Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”.

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit të këtij loti është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur të thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi referuar dispozitave ligjore si më sipërcituar.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 20 % e vlerës së fondit limit të lotit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 55, pika 4(b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55 pika 4 gërma (b) e VKM nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke qënë se vlera e fondit limit është nën kufirin e ulët monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2. Autorizim nga prodhuesi ose nga distributor i autorizuar nga prodhuesi për llojin e mjetit të ofruar. Në rastin e distributorit të autorizuar të paraqitet edhe dokumenti që vërteton se distributori është i autorizuar nga firma prodhuese. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: tel, fax, email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri AK gjykon se autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm i cili garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të mallit objekt prokurimi. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallit që kërkojnë të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë që ka servis të specializuar dhe garanton kryerjen e shërbimeve për riparimin e mjetit objekt i prokurimit, gjatë periudhës së garancisë, në servisin e tij / një servisi të marrë me qera, apo përmes një servisi me të cilin mund të ketë të lidhur një kontratë bashkëpunimi të vlefshme përgjatë kohës së realizimit të kontratës, dhe të specifikojë adresën e servisit.

Argumentimi: Bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se disponojnë mjediset e përshtatshme të autorizuar për kryerjen e shërbimeve të riparimit brenda periudhës së garancisë.

4. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatë të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- ISO 9001:2015 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” (e vlefshme) ose ekuivalent;

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 77 dhe 79 të LPP, të pikës 1, nenit 44, të VKM-së nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Ky kriter është kërkuar me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë sipas objektit të kësaj kontrate. Ky standard përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. Kjo certifikatë lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës me cilësi dhe në kohë.

5. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë katalog ose skedë teknike nga prodhuesi /ose distributori i autorizuar ku të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat teknike të mjetit të ofruar, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat standarte të tenderit, të përcaktuara në Shtojcën 6 të DST-së.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të krahasuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike dhe standartet e kërkuara nga AK me specifikimet teknike për mjetet e ofruara nga operatori ekonomik.

6. Operatori ekonomik duhet të deklarojë që mjetet janë prodhuar në vendet e Bashkimit Europian ose të jenë të prodhuara për përdorim në vendet e BE. Për të vërtetuar këtë duhet të paraqesë deklaratën e cila të jetë e shoqëruar me certifikatën e konformitetit (CoC)/ekuivalent.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar plotësimin e specifikimeve teknike të mallit, objekt prokurimi. Duke qenë se mjeti është kërkuar të jenë prodhuar në vendet e Bashkimit Europian ose të jenë të prodhuara për përdorim në vendet e BE, detyrimisht është kërkuar paraqitja e certifikatës së konformitetit si dokumenti zyrtar i cili vërteton se një produkt plotëson standartet europiane të sigurisë, cilësisë, performancës, emetimit të gazrave dhe mbrojtjes mjedisore. Gjithashtu certifikata është një nga dokumentet e detyrueshëm që shoqëron automjetin për të vijuar me regjistrimin e tij në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor

7. Deklaratë garancie për mjetin e ofruar, ku të jetë përcaktuar periudha e garancisë jo më pak se 5 vjet.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër periudhën e garancisë për mallin e prokuruar. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që malli objekt prokurimi është në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të gjitha riparimet dhe shërbimet e përcaktuara në deklaratë do të kryhen te operatori ekonomik kontraktues.

8. Deklaratë ku merr përsipër dorëzimin e mjeteve të treguara dhe regjistruara në pronësi të autoritetit kontraktor përfitues, ku të ketë të përfshira në çmim të gjithë dokumentacionin përkatës për qarkullim në përputhje me legjislacionin përkatës të Republikës së Shqipërisë.

Argumentim: Në bazë të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e kriterit, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për t’u garantuar se mjeti do të dorëzohet pranë AK i pajisur me të gjithë dokumentacionin e rregullt tekniko-ligjor, i gatshëm për qarkullim rrugor në emër të AK-së

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Specifikime Teknike

Loti 1: Blerje automjete për Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarimit.

SPECIFIKIME TEKNIKE PËR BLERJE MJET MOTORIK ME DJEGIE TË BRENDSHME , LLOJI AUTOVETURË, PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË PËRMBARIMIT

Lloji: Autoveutërë

Motori:

Min 1000CC

1 Lënda djegëse

Naftë ose Benzinë

2 Fuqia motorike

Min 100 Kw

3 konsumi i karburantit (i kombinuar)

Max. 7 litra për 100 km

Transmisioni:

1 Kutia e shpejtësisë

Manuale ose Automatike

2 Shpejtësia maksimale mjeti

Min 120 km/orë

Përmasat e autoveuturës:

1 Gjatësia

Min 3900 mm

2 Gjerësia

Min 1700 mm

3 Lartësia

Min 1450 mm

Gabina:

-Numri dyerve

5

-Numri vendeve

4+1

Sistemi i drejtimit:

Me Timon në krahun e majtë me asistencë hidraulike/elektrike

Ngjyra :

E negociueshme në momentin e lidhjes së Kontratës

Emëtimi i CO (gr/km) max: 210

Klasifikimi mjedisor, min euro 6

OPSIONE STANDARTE TË MAKINËS

1. ESP - program elektronik stabiliteti +ASR
2. ABS- sistem antibllokues
3. Dritat e përparme led

4. Drita antimjegull
5. Ajër i kondicionuar/clima
6. Pasqyrat e jashtme me rregullim elektrik
7. Xhamat e dyerve me komandim elektrik.
8. Mbyllje qendrore me pult
9. Timon i rregullueshëm në lartësi dhe në thellësi
10. Airbag para, anësor dhe mbrapa
11. Gomë rezerve normale, ose kit për fryrje gome
12. Të jetë i shoqëruar me pajisje sipas Kodit Rrugor (kuti e ndihmës së shpejtë, trekëndësh emergjence, jelek fosforisht.)
13. Radio,USB,Bluetooth
14. Disqe gomash alumini
15. Fshirse xhamash automatike me sensor shiu
16. Dalje 12V
17. Sensor parkimi para dhe mbrapa

A. Kërkesa të përgjithshme

1. Mjeti të jetë i pajisur me katalogun e mjetit, çertifikatën e konformitetit, të përkthyer në shqip.
2. Mjeti duhet të jetë i ri, me 0 (zero) km të përshkruara.
3. Viti i prodhimit: Jo më para vitit 2022.

B. Kërkesa të veçanta

Mjeti të shoqërohet me katalog mirëmbajtje, preferohet i përkthyer në shqip.

Operatori duhet të kryej serviset e detyrueshme në kontratë në ambiente jo më larg se 30 km nga Zyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit, Tiranë.

Shënim: Për çdo çertifikatë, standart, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre.

Loti 2: Blerje automjet për Qendrën e Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes.

Të dhënat që kërkohen për automjetin	Përcaktimet
Kategoria	SUV Full Hibrid
Viti i prodhimit	2024 – me i ri
Automjete të reja	Me zero kilometra
Prodhim European (Me çertifikatën C.O.C)	PO
<i>Motorri, Transmesioni, Timoni</i>	
Motorri / Kategoria e emetimeve	Euro 6
Serberatori	≥ 52 Litra
Vëllimi i motorrit (litra)	≥1.6 Litra
Konsumi (për 100 km)	≤ 6,5 Litra
Fuqia “N” (KF) / HP	≥ 200 HP
Kutia e marshave	Automatike
Sistemi i drejtimit	Elektrik ose hidraulik
Timoni	Në anën e majtë me rregullim pozicioni (në lartësi dhe thellësi)
Emetimet CO ₂	≤ 130 gr/km
<i>Përmasat</i>	
Modeli i karrocërisë	SUV (4X4/ AWD)
Gjatësia “L” (mm)	L ≥ 4500
Gjerësia “B” (mm)	B ≥ 1850
Lartësia “H” (mm)	H ≥ 1650
Numri i dyerve (bashke me derën e bagazhit)	5 (pesë)
Numri i vendeve	5 (pesë)
Lartësia nga toka	≥ 17 cm
<i>Lloji i karburantit</i>	Benzinë/ Naftë (Diesel)
<i>Pamja e jashtme</i>	
Boja / Ngjyra	E zezë metalike / blu e errët
Dritat automatike “Full LED”	PO
Sensore dritash dhe parkimi (para & pas)	PO
Kamera parkimi	PO
Disqet e gomave alumin	PO
Grabelinë plastike në pjesën e poshtme të automjetit (motorri dhe kambio)	PO
Pasqyrat me komandim elektrik dhe palosje elektrike	PO
<i>Pjesa e brendshme dhe konforti</i>	
Ajri i kondicionuar	PO
Sediljet lekure	PO
Xhama të errët	Ballor dhe i dyerve të para solar, të pasme të errëta (të prodhuara nga fabrika)
Xhamat e dritareve me komandim elektrik	PO
Radio FM dhe dalje USB	PO
Sistem Navigimi	PO
<i>Siguria</i>	

Mbyllje qëndrore e dyerve me kontroll në distancë	PO
ABS	PO
Airbag	≥ 6
<i>Pajisje të tjera</i>	
Gome rezervë e plotë	PO
Kit për riparimin e gomës (krik, xhiro makine)	PO
Trekëndëshi i emergjencës	PO
<i>Garancia</i>	Jo më pak se 5 vite
<i>Afati i lëvrimin të mallit</i>	2 (dy) muaj nga data e lidhjes së kontratë

Shënim: Për çdo certifikatë, standart, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre.

PËRSHKRIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Automjeti objekt i këtij prokurimi është një mjet transporti institucional. Specifikimet teknike janë përcaktuar me rigorozitet për të garantuar efikasitet, performancë, siguri dhe përshtatshmëri maksimale me nevojat e institucionit.

Karakteristikat e Përgjithshme

Kategoria: SUV Full Hibrid

Arsyetimi: Kategoria SUV Full Hibrid është tipi i përshtatshëm dhe ekologjik për të përmbushur nevojat operationale të institucionit, duke ofruar siguri të lartë dhe hapësirë të mjaftueshme për transportin e stafit.

Viti i Prodhimit: 2024 ose më i vonshëm

Arsyetimi: Viti i prodhimit 2024 ose më i vonshëm siguron që automjeti të jetë i pajisur me teknologjitë më bashkëkohore e cila garanton efikasitet të lartë në konsumin e karburantit dhe ndikim minimal mjedisor, në përputhje me standartet më të fundit.

Gjendja: E re, me zero kilometra

Arsyetimi: Automjeti i ri siguron funksionim të pandërprerë të mjetit dhe shton jetëgjatësinë e tij duke ulur kostot e mirëmbajtjes.

Origjina e Prodhimit: European

Arsyetimi: Kërkohej prodhimi european dhe i pajisur me certifikatën C.O.C në respektim të standardeve të cilësisë, sigurisë dhe emetimeve (Euro 6D) të cilat janë në përputhje me rregulloret dhe normativat europiane, të cilat zbatohen edhe në Shqipëri. Gjithashtu,

disponueshmëria e pjesëve të këmbimit dhe shërbimeve të mirëmbajtjes është e garantuar dhe e lehtësuar.

I. Motorri, Transmisioni dhe Sistemi i Drejtimit

Standardi i Emetimeve: EURO 6

Arsyetimi: Standardi i emetimeve EURO 6 është klasifikimi më i fundit i standardeve europiane të emetimeve dhe siguron ndotje minimale të ajrit. Motori EURO 6 (me emisione CO₂ ≤130 gr/km) është zgjedhur në respekt të mbrojtjes së mjedisit si dhe në angazhim ndaj teknologjive të pastra.

Vëllimi i Motorrit: ≥ 1.6 Litra dhe ≥ 200 HP

Arsyetimi: Madhësi kjo për transport të sigurt dhe ekonomik, duke mbajtur nën kontroll kostot operacionale. Ky interval (≥ 200 HP) siguron ekuilibër midis një lëvizje të sigurt dhe konsumi të karburantit me efikasitet dhe efektivitet. (jo më shumë se 6.5 litra/100 km).

Serberatori ≥ 52 Litra

Arsyetimi: Me qëllim realizimin e sa më shumë km me një mbushje.

Kutia e Shpejtësisë: Automatike

Arsyetimi: Kutia automatike lehtëson drejtimin e mjetit në trafik urban dhe udhëtime të gjata pasi optimizon ndërrimin e marsheve, duke mbrojtur motorin dhe transmisionin nga gabimet e mundshme operacionale.

Sistemi i Drejtimit: Elektrik ose Hidraulik

Arsyetimi: Të dy sistemet ofrojnë asistencë efektive në drejtim, duke e bërë manovrimin më të lehtë dhe më të sigurt.

Timoni: Pozicioni në anën e majtë, i rregullueshëm në lartësi dhe thellësi

Arsyetimi: Pozicionimi majtas është në përputhje me standardet rrugore në Shqipëri. Mundësia e rregullimit të timonit i lejon çdo drejtuesi të gjejë pozicionin optimal të drejtimit.

II. Përmasat dhe Kapaciteti

Modeli i Karrocërisë: AWD (All-Wheel Drive / Tërheqje Integrale)

Arsyetimi: Sistemi i tërheqjes integrale (AWD) është thelbësor për të garantuar që automjeti të arrijë çdo destinacion, pavarësisht kushteve të rrugës. Ky sistem siguron stabilitetin dhe kapjen në terrene të rrëshqitshme (shi, borë, zhavorr), duke ofruar siguri maksimale.

Përmasat e Jashtme:

Gjatësia: ≥ 4500 mm

Gjerësia: ≥ 1850 mm

Lartësia: ≥ 1650 mm

Arsyetimi: Këto përmasa minimale sigurojnë një hapësirë të brendshme të mjaftueshme për pesë pasagjerë. Lartësia e mjetit përmirëson fushëpamjen e shoferit për një siguri më të lartë.

Numri i Dyerve: 5 (përfshirë derën e bagazhit) & Numri i Vendeve: 5

Arsyetimi: E bëjnë të përshtatshëm për transportin e ekipeve të punës, delegacioneve apo stafit të institucionit.

Lartësia nga Toka (Garda): ≥ 170 mm

Arsyetimi: Me qëllim parandalimin e dëmtimeve në pjesën e poshtme të automjetit si dhe mbrojtjen e motorit dhe transmisionit, duke reduktuar kostot e mirëmbajtjes.

III. Lloji i Karburantit

Lënda djegëse: Benzinë ose Naftë (Diesel)

Arsyetimi: Teknologjia hibride ofron efikasitet në konsumin e karburantit veçanërisht në kushtet e trafikut urban si dhe prodhon emetime ndotëse të reduktuara. Kjo sjell kursime të konsiderueshme në buxhetin e karburantit dhe përforcon angazhimin e institucionit ndaj teknologjive të gjelbra kështu që një mjet transporti Benzinë Hibride ose Naftë (Diesel) Hibride do të ishte mjaft e përshtatshme.

IV. Pamja e Jashtme dhe Elementet Funksionale

Ngjyra: E zezë metalike ose Blu e errët metalike

Arsyetimi: Këto ngjyra i japin mjetit një paraqitje dinjitoze, në përputhje me imazhin e institucionit gjithashtu këto ngjyra janë më të lehta për t'u mirëmbajtur.

Dritat: Automatike, me teknologji LED

Arsyetimi: Dritat LED ofrojnë ndriçim më të qartë krahasuar me teknologjitë halogjene, duke përmirësuar ndjeshëm shikueshmërinë. Jetëgjatësia e tyre dhe konsumi i ulët i energjisë reduktojnë kostot e mirëmbajtjes.

Sensorë Dritash dhe Parkimi (para dhe pas) & kamera parkimi

Arsyetimi: Sensorët e dritave automatizojnë funksionimin e tyre, duke rritur sigurinë. Sensorët e parkimit janë thelbësore për një mjet të përmasave SUV si dhe kamera e ndihmon në paraqitjen e një imazhi të saktë dhe të qartë për një levizje të sigurt.

Disqet e Gomave: Material alumini

Arsyetimi: Disqet e aluminit janë më të lehta se ato prej çeliku, gjë që kontribuon pozitivisht në efikasitetin e karburantit.

Mbrojtje e Poshtme e Motorit (Grabelinë plastike)

Arsyetimi: Për të mbrojtur motorin dhe kutinë e shpejtësisë nga dëmtimet e shkaktuara nga guralecat, uji, dhe goditjet në terren të ndryshme, duke zgjatur jetëgjatësinë e komponentëve kritikë.

Pasqyrat e Jashtme: Me palosje elektrike

Arsyetimi: Për të parandaluar dëmtimin e pasqyrave në hapësira të ngushta.

V. Pjesa e Brendshme dhe Komoditeti

Klima: Ajër i kondicionuar

Arsyetimi: Për krijimin e kushteve normale të personave që udhëtojnë.

Tapiceria e Sediljeve: Lëkurë

Arsyetimi: Tapiceria prej lëkure është e lehtë për t'u pastruar dhe mirëmbajtur dhe ka jetëgjatësi më të madhe.

Xhamat e Dritareve: Elektrikë, solarë (pjesa e përparme) dhe të errësuar (pjesa e pasme)

Arsyetimi: Xhamat elektrikë ofrojnë lehtësi në përdorim. Xhamat solarë dhe të errësuar reduktojnë hyrjen e nxehtësisë, përmirësojnë efikasitetin e kondicionerit dhe ofrojnë privatësi për pasagjerët në rast delegacionesh.

Sistemi Multimedia: Radio FM, Portë USB dhe Sistem Navigimi (GPS)

Arsyetimi: Thelbësor për orientimin efikas në destinacione të panjohura, duke kursyer kohë dhe karburant. Lidhja me radio dhe USB siguron informim gjatë udhëtimeve.

VI. Siguria

Mbyllja Qendrore: Me telekomandë

Arsyetimi: Siguron mbylljen e menjëhershme dhe të sigurt të të gjitha dymve.

Sistemi i Frenimit: ABS (Anti-lock Braking System)

Arsyetimi: Parandalon bllokimin e rrotave gjatë frenimit.

Jastëkët e Ajrit (Airbag): Për shoferin dhe të gjithë pasagjerët

Arsyetimi: Për mbrojtjen e personave udhëtues.

VII. Pajisje dhe Dokumentacion Shtesë

Goma Rezervë: Me përmasë të plotë

Arsyetimi: Për të siguruar udhëtim pa vonesa dhe pa kufizime pas një defekti në gomë.

Veglat e nevojshme: Kriko dhe çelës rrotash

Arsyetimi: Për të menaxhuar një situatë defekti, duke ulur varësinë nga shërbimet e jashtme.

Paketa e Sigurisë: Trekëndësh emergjence

Arsyetimi: Në përmbushje të kërkesave ligjore dhe garantimin e sigurisë në rrugë duke sinjalizuar drejtuesit e tjerë të mjeteve në rast ndalese emergjente.

VIII. Garancia

Afati i Garancisë: Minimumi 5 vite pa kufizim kilometrash

Arsyetimi: Një periudhë garancie e gjatë mbron investimin e institucionit duke minimizuar rrezikun financiar nga defektet e papritura dhe riparimet e kushtueshme. Kjo siguron menaxhim efikas dhe parashikueshmëri buxhetore.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar dhe miratuar nga strukturat e posaçme pranë autoriteteve kontraktore përfituese, në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” nenit 15, pika 3/b dhe nenit 40, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Specifikimet teknike, për mallrin objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që e vlerëson mallin si të pranueshëm për funksionet e kërkuara si dhe është në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Specifikimet teknike sipas DST janë hartuar nga grupiet e punës të ngritura nga Titullari i Autoritetit Kontraktor përfitues, në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

NJËSIA E PROKURIMIT